



Datë: 29.10.2025

Numër Protokolli: 7094/2025

A.nr.1368/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1368/2025, të datës 15.07.2025, të parashtruar nga ankuesi K.S, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Adminsitrativ i nisuar sipas ankesës me numër A.nr.1368/2025, të datës 15.07.2025, të parashtruar nga ankuesi K.S.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil K.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 14.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 15.07.2025 nën shenjë A.nr.1368/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Ferizajt, konkursit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1 dhe konkursit me Nr. Reference: RN00017338, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 2, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, për shkak të shkeljeve të rënda procedurale dhe ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 29.08.2025, ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1368/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj, numri i kërkuar gjashtë (6), klasa profesional 1, konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, numri i kërkuar nëntë (9), klasa profesional 1 dhe konkursi me Nr. Reference: RN00017338, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 2, numri i kërkuar katër (4), klasa profesional 1, të gjithë ma afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesi ka aplikuar në të tre konkurset, dhe sipas njoftimi për fazën e verifikimit paraprak i njëjti rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional.

Pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017332, më datë 11.07.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ka publikuar rezultatet përfundimtare kur rezultojnë 19 kandidatë që kanë marr mbi 70 pikë mesin e tyre edhe ankuesi i renditur i 18-ti. Për konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 10.07.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me 18 kandidat që kanë marr mbi 70 pikë, ku rezulton se ankuesi nuk ka arritur të marr 70 pikë. Për konkursin me Nr. Reference: RN00017338, më datë 11.07.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës ka shpallur njoftimin për rezultatet përfundimtare me gjithsej 11 kandidatë që kanë marrë mbi 70 pikë, ndërsa, rezulton se ankuesi nuk është pjesë e kësaj liste për shkak që nuk ka kaluar prapun prej 70 pikëve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër këtyre tri procedurave, pretendon se ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore, duke kërkuar që konkurset të shpallen të pavlefshme dhe po ashtu rezultatet përfundimtare.

Në procedurën e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, kandidati Nderim Gashi, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimi më Nr. Ref: RN00017340.

Në procedurën e pranimi sipas konkursit me konkursit me Nr. Reference: RN00017338, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 2, kandidatja L.S, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1515/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimi më Nr. Ref: RN00017338.

Në procedurën e pranimi sipas konkursit me konkursit me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj, kandidati L.J, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimi më Nr. Ref: RN00017332.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1368/2025, të datës 15.07.2025, ka të bëjë me procedurat e pranimi për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, Vendimin A.nr.1515/2025, të datës 01.10.2025 dhe Vendimin A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këto procedura, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1368/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1368/2025, të datës 15.07.2025.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1368/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit K.S;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së